



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA

KF.nr.4/22

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtarin Fisnik Nuli dhe me bashkëpunëtorin profesional Visar Gashi, në konfliktin administrativ të paditësit N.P.N “V...”, me seli në Gjilan, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve “SCLR Partners” sh.p.k, kundër të paditurit Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë, duke vendosur lidhur me padinë e paditësit për anulim vendimi, objekt kontesti vlerësim dhe ndëshkime tatimore, vlerë kontesti e papërcaktuar, në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor-publik, të mbajtur me datë 29.09.2022, në prani të përfaqësueses së paditësit G.B, dhe në mungesë të palës së paditur, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET kërkesëpadia e paditësit N.P.N “V...”, me seli në Gjilan, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve “SCLR Partners” sh.p.k, si e pa bazuar.
- II. MBETËT NË FUQI Aktvendimi nr.472/2017 i datës 15.01.2018, i Administrata Tatimore e Kosovës në Prishtinë.
- III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi me padinë e parashtruar në gjykatë me datë 08.02.2018, deklaroi se ZGJONA dhe më pas ATK me vendimin kontestues kanë vepruar në kundërshtim me gjendjen faktike dhe me dispozitat në fuqi, për arsye se ATK-ë me raportin e rivlerësimeve, e më pas edhe

me vendimin kontestues nuk ka pranuar TVSH-në tek blerjet për vitin 2014, me arsyetim se për të gjitha periudhat e kontrollit tatimpaguesi ka deklaruar në ATK 0.00 (zero) qarkullim edhe pse i njëjti ka pasur transaksione të shitjes dhe blerjes, duke vepruar kështu në kundërshtim me nenin 18 të Ligjit Nr.03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat. Ngase ATK këto konstatime i nxjerrë duke u bazuar në ligjet aktuale, të cilat blerje konsiderojmë se është dashur të trajtohen me ligjet e vitit kur kanë ndodhur pasi që ligjet në fuqi nuk kanë veprim retroaktiv. Andaj, TVSH është dashur që të pranohet, pasi që këto blerje për këtë vite janë blerje të cilat kanë ndodhur dhe trajtimi i tyre nuk mund të bëhet me ligjet dhe udhëzimet aktuale. E njëjta gjë vlen edhe për TVSH-në për vitin 2015, ku ATK në mënyrë të pa bazuar ka përcaktuar obligime tatimore në kategorinë e lartcekur, sepse edhe për këtë vlen e njëjta, pasi që edhe në këtë rast ATK është dashur të zbatoj ligjet dhe udhëzimet konform periudhës së operimit, pra para vitit 2015. Tutje, asetet e shitura nuk mund të trajtohen si mallra dhe shërbime sepse këto kanë tretman tjetër, pasi që janë makineri, e të cilat pajisje u nënshtrohen korrigjimit të vlerës, dëmtimit dhe trajtimi i tyre nuk mund të futet sipas nenit 24 të Ligjit Nr.05/L-37 për TVSH-në. Andaj, kontestimet e ATK-së me raportin e Kontrollit duhet të korrigjohen për vlerën shtesë si e hyrë kapitale, gjithashtu edhe këtu është dashur që nga ATK të pranohet pjesa e TVSH-në në blerje të aseteve. Pastaj se në Raportin e Kontrollit janë përfshirë edhe faturat e një kompanie tjetër - "C...", të cilat është dashur të largohen sepse nuk kanë të bëjnë me biznesin e tatimpaguesit, dhe atë Faturat: nr. ... e dt.30.07.2017, nr. ... e dt.30.08.2016, nr. ... e dt.11.09.2016, nr. ... e dt.11.10.2016, nr. ... e dt.01.10.2016, nr. ... e dt.25.11.2016, nr. ... e dt.30.11.2016, nr. ... e dt.30.12.2016, nr. ... e dt.30.06.2016, nr. ... e dt.25.05.2016, nr. ... e dt.20.04.2016, nr. ... e dt.30.02.2016, nr. ... e dt.30.03.2016 dhe nr. ... e dt.30.01.2016. Po ashtu, paditësi konsideron se është i pa bazuar edhe asyeimi i ATK-së i dhënë në vendimin e kontestuar se sa i përket aseteve i kemi trajtuar si shitje, pasi të njëjtat janë mbështetur në provat e siguruara nga palët e treta. Ngase për vitin 2015 kemi blerjet e aseteve dhe këtu është bërë gabim nga ATK, pasi që në Raportin e Kontrollit kemi shitjen e dy pompave 89,000 €, ndërsa gjendja faktike është krejt ndryshe, ku në librat e tatimpaguesit ka të evidentuar vetëm një shitje të një pompe bë shumë prej 89,000 €, ndërsa pompa tjetër ka mbetur te tatimpaguesi për faktin se e njëjta ka pasur defekte të shumta të cilat kanë pamundësuar funksionimin e të njëjtës. ATK-ja është dashur të largonte pjesën shtesë të

sitjes së aseteve, sepse këtu është shitur siç u sqarua më lartë vetëm një pompë, ku ATK është dashur ta pranonte si shumë të sitjes prej 89,000.00 €, ndërsa diferenca është dashur të njihej po nga ATK si humbje kapitale, pretendim ky i paraqitur edhe pranë Departamentit të Ankesave të ATK-së, mirëpo të njëjtin e ka refuzuar si të pa bazuar, pa argumentuar fare se pse e ka refuzuar. Gjithashtu, edhe për vitin 2016 Raportet e Kontrollit nuk përputhen me shënimet, duke u përfshirë faturat e “C...” në shitje të cilat siç u cek më lartë duhet të largohen nga qarkullimi për arsyet e lartcekura, dhe të cilat zvogëlojnë qarkullimin për 349,124.32 € me TVSH, e që vlera e TVSH-së së brendshme është 53,256.7 €, ndërsa pjesa prej 295,867.62 € duhet të largohet nga qarkullimi, dhe se në vitin 2016 kemi shitje me TVSH prej 586,617.71 €, e jo ashtu siç e ka përcaktuar TVSH në Raportin e Kontrollit. Shpenzimet e procedurës i kërkon.

E paditura, në përgjigjen në padi të datës 11.12.2019 ka deklaruar se Administrata Tatimore e Kosovës si palë e paditur në këtë konflikt administrativ, për qëllime të përgjigjes në padi, i kundërshton në tërësi pretendimet e paraqitura në padi si të pabazuara në ligj dhe fakte materiale, dhe vlerëson se vendimi i DA të ATK-së Nr. ... i datës 15.01.2018, është i drejtë dhe në harmoni me legjislacionin tatimor të aplikueshëm në Republikën e Kosovës. Andaj e paditura i propozon gjykatës që ta refuzojë padinë e paditësit, dhe ta vërtetoj vendimin e Departamentit të Ankesave të ATK-së, Nr. ... të datës 15.01.2018 lidhur me subjektin NPN “V...”. Shpenzimet e procedurës nuk i kërkon.

Gjykata ka shqyrtuar këtë konflikt administrativ komfor dispozitave të nenit 41, të LKA-së për arsye se e paditura përmes parashtresë së datës 16.09.2022 e ka njoftuar gjykatën se nuk do të prezantoj në këtë seancë dhe ka kërkuar nga gjykata që të veproj në pajtim me nenin 38 paragrafi 5 të LKA-së. (provë: Parashtresa e datës 16.09.2022 nga ATK),

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor-publik të datës 29.09.2022, ka administruar provat dhe atë: Vendimi nr.472/2017 i datës 15.01.2018, Vendimi nr.593/2017 i datës 12.10.2017, Tabelat nga Librat për vitin 2014, 2015 dhe 2016, Pasqyra e Tatimpaguesit e nxjerrë nga ATK së bashku me gjendjen e përgjithshme të deklarimeve e datës së printimit 18.10.2017, Faturat

..., ..., ..., ..., ..., ..., ..., ..., ..., ..., ..., ..., ..., Njoftimi për Barrë dhe Masë për Marrje Pasurie nr. ..., Konfirmimi i Vënies së Barrës i datës 16.01.2018, Kontrata e Punës nr. ... së bashku me pjesën 2 dhe 3 të Kontratës, Vendimi nr. ..., Kontrata me numër të prokurimit ..., Kontrata Publike nr.5332/21.10.2016, Deklarata për Specifikacionet Teknike e datës 28.04.2016, Kontrata dhe Kushtet e Veçanta dhe Anekset e Ndërlidhura me numër të identifikimit ..., Tabela Gjendja e Borxheve e datës së printimit 26.08.2020, Përgjigja në Padi e datës 11.12.2019, Ekspertiza Financiare e datës 19.05.2022, e punuar nga Eksperti Financiar M.P, Libri i Blerjeve për vitin 2014, 2015, 2016, Ankesa e ushtruar në ATK 472/17 e datës 17.11.2017, Stoku i datës 31.12.2015, Libri i Shpenzimeve 2015, 2016 dhe Libri i Shitjeve 2015, 2016.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thëniet në padi, përgjigjes në padi, shkresave të lëndës në këtë konflikt administrativ, bëri ballafaqimin e provave që kanë ofruar të dy palët, dhe bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8, i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), dhe arriti në përfundimin se në këtë konflikt administrativ, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Nga provat e administruara në këtë konflikt administrativ, nga deklarimet në padi, shkresat e lëndës, vendimi kontestues, dhe deklarimeve në seancën e shqyrtimit gjyqësor Kryesor, Gjykata ka gjetur se nuk është kontestuese fakti se i padituri ka ushtruar kontroll tek këtu paditësi për këto periudha dhe lloje të tatimit, dhe atë për TVSH-ë, PD-ë, CI-ë, ËM-ë dhe CM-ë periudha 01.01.2014 deri 31.12.2016, e ku edhe janë konstatuar ndryshime që kanë rezultuar nga parregullsitë e evidentuara në deklarimet e këtu paditësit. Tutje nuk është kontestues as fakti se këtu paditësi me datë 17.11.2017 ka ushtruar ankesë në ATK-ë, e për të cilën ankesë këtu e paditura me datë 15.01.2018 ka sjell vendimin nr. 15.01.2018, si akt administrativ përfundimtar i nxjerrë në procedurën administrative në shkallë të dytë, me të cilin ka refuzuar kërkesën e subjektin në procedurë, e kundër të cilit, paditësi me padinë e datës, 08.02.2018, ka iniciuar konfliktin administrativ pranë kësaj gjykate.

Për të vërtetuar konstatimet e cekura si në arsyetimin e vendimit kontestues dhe pretendimet e paditësit të paraqitura në padi dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor, Gjykata sipas

propozimit të autorizuarit të palës paditëse përmes aktvendimit A.nr.213/18 të datës 13.10.2021 ka caktuar ekspertizë financiare, përmes të cilës e ka obliguar ekspertin financiar që të konstatoj librat e shitjes-blerjes, transaksionet bankare, deklarinimet e tatimpaguesit, të gjitha këto për periudhën kontestuese të vitit 2014-2016, duke krahasuar me Raportin e Kontrollit sipas të cilit raport është vlerësuar se paditësi duhet të paguajë tatimin shtesë në vlerë prej 629,336.72 €. Eksperti financiar Mentor Prekazi, në ekspertizën e datës 19.05.2022 dhe në seancën e shqyrtimit kryesor, ka dhënë mendimin dhe konstatimin se pas pranimit të librave të shitjeve dhe blerjeve për vitet 2014, 2015 dhe 2016, dhe pas analizës së tyre eksperti financiar ka konstatuar se me përjashtime të caktuara të paraqitjeve të vlerave financiare, tatimpaguesi i ka mbajtur evidencat në mënyrë të rregullt për të gjitha vitet 2014,2015 dhe 2016, por që të njëjtat vlera nuk i ka deklaruar përmes deklaratave taimore të TVSH-së, respektivisht të gjitha deklarinimet i ka bërë me zero, në kohën kur ka pasur aktivitete të shitjes, e që është në kundërshtim me nenin 18 të Ligjit Nr.03/L-222 për ATP, respektivisht me nenin 38.2 të Ligjit Nr.03/L-146 (për 01/2014-09/2015) dhe të Ligjit Nr.05/L-037 për TVSH-në (prej 09/2015). Si rrjedhojë, Tatimpaguesi nuk mund të shfrytëzoj TVSH-në e zbritshme në blerjet e bëra, dhe njëkohësisht nuk e ka shfrytëzuar mundësinë kohore të përcaktuar me nenin 38.2 të Ligjit Nr.05/L-037 për TVSH-në, në kohën kur ka pasur të drejtën e zbritjes, jo më larg se periudha e fundit e vitit kalendarik që vijon pas vitit në të cilin ka pasur të drejtën e zbritjes së TVSH-së. Po ashtu, eksperti financiar ka konstatuar se në faqen 3 të vendimit Nr. ... të ATK/D/A, nga ATK-ja janë precizuar ligjet e përdorura në periudhat përkatëse, respektivisht neni 38.2 të Ligjit Nr.03/L-146 për TVSH-në për periudhën (01/2014 – 09/2015), dhe nenin 38.2 të Ligjit Nr.05/L-037 për TVSH-në (prej 09/2015). Ndërsa sa i përket aseteve të shitura të cilat sipas paditësit nuk duhet të trajtohen si mallra, por me rastin e shitjes si fitim apo humbje kapitale, Ekspertit Financiar në takimin e datës 11.05.2022 nuk ka mundur ti dëshmojë të kundërtën e vlerësimit të ATK-së të bazuar në nenin 24 të Ligjit Nr.05/L-037 për TVSH-në, derisa për pikën e precizuar referuar një bageri se i njëjti ka qenë i prishur dhe është shitur nën çmimin e tregut dhe si rezultat kanë pas humbje kapitale, eksperti financiar ka konstatuar se këtu paditësi nuk ka mundur ti dëshmojë ekspertit financiar të kundërtën e vlerësimit të ATK-së, respektivisht nuk është paraqitur ndonjë vlerësim/konstatim profesional lidhur me nivelin e dëmtimit të pasurisë

së shitur nën çmimin e tregut. Eksperti financiar ka vërtetuar konstatimet e të paditurës edhe lidhur me 14 faturat shitëse të kontestuara, se të njëjtat përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara sipas nenit 45, të ligjit mbi TVSH-në nr. 03/L-146 dhe 05/L-037 dhe se të njëjtat janë të nënshkruara nga paditësi.

Gjykata e mori në tërësi si të bazuar dhe i'a dha besimin e plotë ekspertizës së lartpërmendur dhe sqarimeve të ekspertit në seancë, ngase ekspertiza i përmban elementet e nevojshme të dhëna mbi bazën e njohurive profesionale, dhe e arsyetuar mjaftueshëm e të cilat gjykata i vlerësoj si të drejta për vërtetimin e fakteve vendimtare në këtë konflikt administrativ, si dhe e njëjta është në harmoni me legjislacionin tatimor të aplikueshëm në Kosovë.

Gjykata i vlerësoj të pa bazuara pretendimet e paditësit në padi, sepse të njëjtat janë në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuara nga ana e organit të paditur, në kundërshtim me të gjeturat e ekspertit financiar si dhe në kundërshtim me provat në shkresat e lëndës dhe me dispozitat ligjore në fuqi.

Sa i përket pretendimit të paditësit lidhur me mos njohjen e TVSH-së së zbritshme nga kontrolli pranë këtu të paditurës, gjykata e pranon si të bazuar arsyetimin e vendimit kontestues, për arsye se për të gjitha periudhat e kontrollit tatimpaguesi ka deklaruar në ATK-ë 0.00, zero qarkullim edhe pse i njëjti ka pasur transaksione të shitjes dhe blerjes duke vepruar kështu në kundërshtim me neni 18, të ligjit 03/L-222, dhe neni 38, paragrafin 2 të ligjit 03/L-146 për Tatimin mbi vlerën e shtuar për periudhat e kontrollit 01.2014 deri 09.2015, dhe neni 38 paragrafin 2, të ligjit 05/L-037 për TVSH-ë për periudhat e kontrollit nga 09.2015 deri 12.2016, pasi që u konstatuar se këtu paditësi nuk e ka zbritur vetë TVSH-në e tije të zbritshme me kohë, në periudhën tatimore kur ka pasur të drejtën e zbritjes mirëpo jo më larg se periudha e fundit e vitit kalendarik që vijon pas vitit në të cilin e ka pasur të drejtën e zbritjes së TVSH-së. Edhe vlerësimin e të paditurës lidhur me mos njohjen e shpenzimit të kredive si shpenzime të zbritshme dhënë në vendimin kontestues gjykata e pranon si të drejtë, ngase vet tatimpaguesi këtu paditësi nuk ka deklaruar fare të hyrat dhe as shpenzimet për qëllime tatimore, sepse i njëjti për të gjithë

periudhën e kontrollit ka deklarim 0.00 zero. Lidhur me këto pika kontesti eksperti financiar Mentor Prekazi në ekspertizën financiare të datës 19.05.2022, ka dhënë mendimin e tij se : pas pranimit të librave të shitjeve dhe blerjeve për vitet 2014, 2015 dhe 2016, dhe pas analizës së tyre me përjashtime të caktuara të paraqitjeve të vlerave financiare, tatimpaguesi i ka mbajtur evidencat në mënyrë të rregullt për të gjitha vitet 2014,2015 dhe 2016, por që të njëjtat vlera nuk i ka deklaruar përmes deklaratave tatimore të TVSH-së, respektivisht të gjitha deklaratimet i ka bërë me zero, në kohën kur ka pasur aktivitete të shitjes, e që është në kundërshtim me nenin 18 të Ligjit Nr.03/L-222 për ATP, respektivisht me nenin 38.2 të Ligjit Nr.03/L-146 (për 01/2014-09/2015) dhe të Ligjit Nr.05/L-037 për TVSH-në (prej 09/2015). Si rrjedhojë, Tatimpaguesi nuk mund të shfrytëzoj TVSH-në e zbritshme në blerjet e bëra, dhe njëkohësisht nuk e ka shfrytëzuar mundësinë kohore të përcaktuar me nenin 38.2 të Ligjit Nr.05/L-037 për TVSH-në, në kohën kur ka pasur të drejtën e zbritjes, jo më larg se periudha e fundit e vitit kalendarik që vijon pas vitit në të cilin ka pasur të drejtën e zbritjes së TVSH-së. Po ashtu, eksperti financiar ka konstatuar se në faqen 3 të vendimit Nr.472/2017 të ATK/D/A, nga ATK-ja janë precizuar ligjet e përdorura në periudhat përkatëse, respektivisht neni 38.2 të Ligjit Nr.03/L-146 për TVSH-në për periudhën (01/2014 – 09/2015), dhe nenin 38.2 të Ligjit Nr.05/L-037 për TVSH-në (prej 09/2015).

Sa i përket pretendimit të paditësit lidhur me asetet e shitura , gjykata e pranon si të bazuar arsyetimin e vendimit kontestues, për arsye se e paditura asetet i ka si shitje bazuar në provat materiale të siguruara dhe atë faturat nga subjekti i tretë "B... Sh.P.K., Ndërsa lidhur me atë se ka pasur asete të dëmtuara këtu paditësi nuk ka prezantuar asnjë provë materiale për ta dëshmuar të kundërtën e konstatimit nga këtu e paditura. Lidhur me këto pika kontesti eksperti financiar Mentor Prekazi në ekspertizën financiare të datës 19.05.2022, ka dhënë mendimin e tij se: në takimin e datës 11.05.2022 këtu paditësi nuk ka mundur ta dëshmojë të kundërtën e vlerësimit të ATK-së, kjo bazuar në nenin 24 të Ligjit Nr.05/L-037 për TVSH-në, derisa për pikën e precizuar referuar një bageri se i njëjti ka qenë i prishur dhe është shitur nën çmimin e tregut dhe si rezultat kanë pas humbje kapitale, eksperti financiar ka konstatuar se këtu paditësi po ashtu nuk ka mundur të dëshmojë të kundërtën e vlerësimit të ATK-së, respektivisht nuk është paraqitur nga këtu paditësi

ndonjë vlerësim/konstatim profesional lidhur me nivelin e dëmtimit të pasurisë së shitur nën çmimin e tregut.

Sa i përket pretendimit të fundit të paditësit lidhur me trajtimin si shitje të faturave të tatimpaguesit këtu paditësit me subjektin "C..." Sh.P.K., gjykata e pranon si të bazuar arsyetimin e vendimit kontestues, për arsye se faturat e kontestuarra përmbajnë të gjitha të dhënat dhe elementet e faturës tatimore sipas nenit 45 të ligjit 03/L-146 për TVSH-ë, nenit 45 të ligjit 05/L-037 për TVSH-ë, tutje faturat janë të nënshkruara nga lëshuesi dhe pranuesi i faturës dhe po ashtu janë të vulosura nga të dyja palët. Lidhur me këtë pikë kontesti eksperti financiar M.P në ekspertizën financiare të datës 19.05.2022, ka dhënë mendimin e tij se: faturat shitëse të kontestuarra përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara sipas nenit 45, të ligjeve mbi TVSH-në nr. ... dhe ... dhe se të njëjtat janë të nënshkruara nga paditësi.

Nga të gjeturat si në vendimin kontestues, në vendimin për vlerësim të ndëshkimeve dhe gjobave nr. ... të datës 12.10.2017, vlerësimet si më lartë dhe konstatimet nga ekspertiza financiare e datës 19.05.2022, Gjykata ka gjetur në mënyrë të pa kontestueshme se këtu paditësi për periudhën 01/2014 deri 12/2016 për llojin e tatimit TVSH-ë, CI dhe PD-ë, mbi bazën e qarkullimit shtesë ka konstatuar tatim shtesë prej 629,336.72 euro, e për të cilin tatim shtesë këtu e paditura ka aplikuar edhe ndëshkim prej 25%, në këtë shumë, dhe e cila arrin shumën prej 157,334.18 euro bazuar në dispozitat nga neni 52, par 4, i ligjit 03/L-222, dhe gjobë në shumë prej 1,000.00 euro bazuar në nenin 53, par 2.4 të ligjit 03/L-222, sipas vendimit për vlerësim të ndëshkimeve dhe gjobave nr. ... të datës 12.10.2017. Gjykata ka analizuar dispozitat ligjore nga neni 52 të ligjit 03/L-222, ku shprehimisht thuhet se : paragrafi 1, *'Kur nga një person kërkohet të plotësojë një deklaratë tatimore sipas legjislacionit të zbatueshëm në Kosovë nën-deklaron shumën korrekte të obligimit tatimor apo mbi-deklaron shumën korrekte të një rimbursimi tatimor për të cilin ata kanë të drejt, personi i tillë do t'i nënshtrohet një ndëshkimi administrativ prej'*: nën par 1.2, *'njëzetepesë për qind (25%) e ndryshimit mes shumës korrekte të tatimit që duhet të ishte deklaruar dhe shumës që në të vërtetë është deklaruar aty ku ndodh që nën-deklarimi i tillë ose mbi-deklarimi sipas nën-paragrafit 1.1. të këtij paragrafi është me shumë se dhjetë*

përlind (10%) e shumës korrekte të tatimit“, dhe nenit 53, par 2, të këtij ligji i cili decidivisht përcakton se : ‘*Çdo person i nga i cili kërkohet të krijojë ose mbajë regjistrime, përfshirë kërkesën për të vendosur numrin fiskal të biznesit në të gjithë kuponët dhe faturat e lëshuara, sipas legjislacionit të zbatueshëm në Republikën e Kosovës dhe i cili nuk e kryen këtë do t’i nënshtrohet një ndëshkimi administrativ si vijon:’*’, nën par 2.4, ‘*tatimpaguesi me qarkullim vjetor prej pesëqind mijë (500,000) dhe më shumë – ndëshkim administrativ prej njëmijë (1,000) Euro’*’. Gjykata nga interpretimi i drejtë i këtyre dispozitave ligjore ka gjetur se në këtë çështje administrative, drejt është vërtetuar gjendja faktike, nga e cila del se nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit, andaj pretendimet e paditësit nuk i aprovoi, sepse i vlerësoi pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo që është vërtetuar nga ana e organit të paditur.

Si rezultat, Gjykata konsideron se paditësi në këtë konflikt administrative ka dështuar që të prezantojë provat me të cilat do të mbështet pretendimet e tija në padi, për arsye se është obligim i palës paditëse që të prezantojë para Gjykatës faktet me të cilat e mbështet kërkesën e tij, si dhe një përmbledhje të arsyetimit ligjor dhe faktik të padisë. Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se vendimi i kontestuar është i qartë dhe i kuptueshëm dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo Gjykatë, duke vlerësuar se edhe e drejta materiale është zbatuar drejt.

Mbi këtë gjendje të fakteve, ekspertizës financiare të datës 19.05.2022, shkresave të lëndës dhe administrimit të provave, Gjykata konstaton se vendimi nr. ... i datës 15.01.2018 i Administratës Tatimore të Kosovës në Prishtinë, me të cilin është refuzuar ankesa e paditësit, është plotësisht i drejtë dhe i bazuar në dispozitat ligjore në fuqi.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, Gjykata konform dispozitave ligjore të nenit 43, par 1, dhe 46, par 1 dhe 2, të LKA-së, Ligji nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE

Dhomat e Shkallës së Parë / Departamenti Fiskal

KF.nr.4/2022, datë 29.09.2022

Bashkëpunëtori Profesional

Visar GASHI

Gj y q t a r i

Fisnik NULI

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj Gjykate.